



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve -Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Balanca Vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës 2020





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve –Ministartstvo za Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labor and Transfers

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Balanca Vjetore e Energjisë në Republikën e Kosovës 2020



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Qershor, 2021

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qasenë përmes veb-faqes së ASK-së

në internet: <http://ask.rks-gov.net>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Financije, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labor end Transfers*
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

BALANCA VJETORE E ENERGJISË
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, 2021

P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur Balancën Vjetore të Energjisë në Republikën e Kosovës për vitin 2020.

Duke u bazuar në kërkesa të vazhdueshme nga shfrytëzues të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm dhe në bazë të indikatorëve që publikon EUROSTAT-i për statistika energjetike, kemi prezantuar të dhëna me interes.

Publikimi do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së dhe do të shërbejë si informacion i dobishëm dhe relevant ekonomik për Kosovën.

Të gjitha komentet dhe propozimet nga ana e shfrytëzuesve të këtyre të dhënave do të pranohen me kënaqësi dhe janë të mirëseardhura.

Publikimin e përgatitën:

Ismajl Sahiti – ZV. Drejtor i Departamentit

Hysni Elshani – ZV.Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike

Bekim Bojku – Zyrtar

Qendresa Shala – Zyrtare

Vivianit Fejza – Zyrtar

Ahmet Cakolli – Zyrtar për dizajn

Qershor, 2021

Z.V. i Kryeshefit Ekzekutiv në ASK
Ilir.T. Berisha

Përmbajtja

	Faqe
1. Balanca Vjetore e Energjisë për vitin 2020	1
1.1. Burimet primare të energjisë	1
1.1.1. Thëngjilli.....	2
1.1.2. Produktet e naftës	3
1.1.3. Biomasa (dru zjarri)	4
1.1.4. Energjia elektrike	4
1.1.5. Hidroenergjia	4
1.1.6. Energjia e Erës	5
1.1.7. Energjia solare	5
1.1.8. Biokarburantet	5
1.2. Konsumi final i energjisë.....	5
1.2.1. Konsumi final i thëngjillit	8
1.2.2. Konsumi final i produkteve të naftës.....	9
1.2.3 Konsumi final i energjisë elektrike.....	10
1.2.4. Konsumi final i ngrohjes së përfituar	11
1.3. Konsumi i energjisë në sektorin e industrisë	12
1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë	12
1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë	13
1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë	14
1.3.4 Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë	15
1.3.5 Pjesëmarrja e degëve të industrisë në konsumin e energjisë	16
1.4. Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë	17
1.4.1. Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë	17
1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë	18
1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë.....	19
1.5. Konsumi i energjisë në sektorin e shërbimeve	20
1.5.1.Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e shërbimeve	20
1.5.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e shërbimeve	22
1.5.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve	22
1.6. Konsumi i energjisë në sektorin e transportit	23
1.6.1. Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e transportit	23

1.7. Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë.....	24
1.7.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë.....	24
1.7.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë.....	26
1.7.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë.....	26
1.8. Mbulimi i kërkesës me energji në të gjithë sektorët	27
1.8.1. Furnizimi me thëngjill (linjit)	27
1.8.2. Furnizimi me energji elektrike	28
1.8.3. Furnizimi me produkte të naftës.....	28
1.9. Indikatorët e energjisë	29
SH T O J C A T	30

Shkurtesat

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
KEK sh.a	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuidim dhe Furnizim me Energji Elektrike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
KE	Komuniteti i Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
CRES	Qendra për burime të ripërtëritshme dhe kursim të energjisë, Athinë-Greqi
AIE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hidrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor
CO	Monoksid i karbonit
VOC	Përbërje organike lehtë e avullueshme
NO _x	Oksidet e azotit- NO dhe NO ₂
CO ₂	Dioksid i karbonit
SO ₂	Dioksid i sulfurit
ktoe	Kilo ton oil ekuivalent

Shpjegimet metodologjike përkufizime

Prodhimi primar është lloj i energjisë i cili nuk ishte ndryshuar me çdo transformim gjatë procesit të konvertimit (për shembull: qymyrit, naftës, gazit natyror, biomasa, hidroenergji, energjia e erës dhe energjisë solar (diellore).

Ndryshimi i stokut është një dallim në mes rezervave në ditën e parë të vitit (rezervat fillestare) dhe rezervat në ditën e fundit të vitit (rezervat e fundit).

Dallimi statistikor është një kategori që përfshin shumën e dallimeve të pashpjegueshme statistikore në mes të prodhimit dhe konsumit për energjentë të caktuar.

Konsumi në brendësi bruto është llogaritur si në vijim:

Prodhimi primar
+ Import
- Eksport
+ ndryshimet e Stokut

¹**Energjia Elektrike** - Nënkupton formën e energjisë e cila transportohet përmes përçuesve metalik.

Energjia - Do të thotë çdo formë e prodhuar ose e fituar e energjisë (energji elektrike, ngrohja ose gaz natyror) me qëllim të furnizimit ose shitjes.

Energjent - Lëndët djegëse të cilat gjatë djegies lirojnë energji me një fjalë quhen energjent.

Ndërmarrja e energjisë – Nënkupton ndërmarrjen e energjisë e cila ushtron një rrëzë ose më shumë nga aktivitetet energjetike në vijim: prodhimin, transformimin, bartjen, shpërndarjen, furnizimin, tregtimin ose deponimin e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje ose gaz natyror në bazë të një licence të lëshuar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë apo pa licencë nëse licenca në fjalë nuk kërkohet.

Prodhimi i thëngjillit – Paraqet sasinë e thëngjillit që nxirret nga minierat.

Prodhimi i energjisë elektrike - Paraqet sasinë e energjisë që prodhohet në Termocentrale dhe Hidrocentrale.

Prodhimi i Energjisë – Nënkupton prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes ose ndonjë forme tjetër të energjisë.

Bruto Prodhimi i Energjisë – Paraqet gjithë sasinë e prodhimit të Energjisë Elektrike në Termocentrale apo Hidrocentrale.

Neto Prodhimi i Energjisë – Paraqet sasinë e Energjisë Elektrike në prag.

Importi i energjisë elektrike – Paraqet sasinë e energjisë elektrike që blihet jashtë kufijve të shtetit.

Eksporti i energjisë elektrike – Paraqet sasinë e energjisë që shitet jashtë kufijve të shtetit.

¹ Shpjegimet metodologjike janë marrë nga Ligji për Energji Nr. 2004/8.

Këmbimet e energjisë elektrike – Paraqesin sasinë e energjisë elektrike e cila këmbëhet me energji jashtë vendit.

Humbjet e energjisë elektrike – Paraqesin atë sasi të energjisë elektrike e cila humbet në transmision dhe shpërndarje.

Konsumator - do të thotë konsumatori për blerje me shumicë ose konsumatori i fundit i energjisë.

Konsumatorët e privilegjuar (220 -110kV) – janë konsumatorët të mëdhenj (0.4 KV) që ushtrojnë statusin e konsumatorit të privilegjuar.

Shpërndarja – do të thotë transporti i energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror me anë të linjave të tensionit të lartë, të mesëm ose tubacioneve me presion të mesëm ose të ulët më qëllim të dërgimit tek konsumatorët, por duke mos përfshirë furnizimin.

Qymyr- briket, forme vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuara prej qymyri.

Linjit- nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi.

Torfe- (duke përfshirë mbeturinat e tij), nëse është apo jo i aglomeruar.

Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit. Linjiti apo prej torfe. Nëse është apo jo i aglomeruar ; karbon i konvertuar:

Qymyr gaz, gaz ujë, gaz prodhues, gaz i dobët dhe gaze të ngjashme (EXCL. gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera të gazta)

Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katran tjetër, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluar.

Vajra dhe produkte të tjera të distilimit në temperatura të larta të katranit të qymyrit; produkte të ngjashme në të cilat pesha e përbërësve aromatik e tejkalon ato të atyre jo aromatike.

Terpentinë dhe koks terpentinë, fituar nga katrani i qymyrit apo prej katranëve të tjera minerale.

Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, bruto.

Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndrysho nga bruto; preparate të paspecifikuara dhe të pa përfshira diku tjetër, që përmbajnë ndaj peshës 70 % apo më shumë vajra naftë apo vajra të fituara nga mineralet bituminoze. këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të preparatit.

Gazet e naftës dhe hidrokarbure tjera gazoil.

Xhelatinë naftë; dyllë parafine, dyllë mikrokristalin prej naftës, dyllë i lëngshëm, ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dyllë tjera të mineraleve, dhe produkte të ngjashme të fituar nga sinteza apo nga procese të tjera, nëse janë, apo nuk janë të ngjyrosura.

Kokos naftë, bitum naftë dhe mbetje të tjera të vajrave të fituar prej mineraleve bituminoze.

Bitum, bituminoze ose vaj-tar shist argjilor dhe rëre, asfalt dhe gurë asfalti

Mastikë bituminoze të mbështetura dhe përzierjet tjera bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, bitum mbi natyrore, në bitum naftë ose në katranit mineral.

Përmbledhje ekzekutive

“Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2020” është përgatitur nga Agjencia e statistikave të Kosovës.

Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2020 është përgatitur në harmoni me Ligjin për Statistika Nr. 04/L-036, Ligji për Energjinë Nr.05-81, Neni 8, Paragrafi 13.

Në këtë dokument pasqyrohen rrjedhat fizike të energjisë të të gjitha llojeve dhe burimeve që janë përdorur në Kosovë gjatë vitit 2020.

Burimet e të dhënave

Të dhënat e nevojshme për hartimin e bilanceve energjetike sigurohen nga:

1. Sondazhe të rregullta statistikore nga fusha e Statistikave të energjisë ;
2. Sondazhe të rregullta statistikore:
Tregtisë së Jashtme dhe Transportit,
Ndërtimi,
Bujqësisë dhe Pylltarisë;

Njësitë Raportuese të statistikave të energjisë

Njësitë raportuese për bilancin e energjisë elektrike janë:

Prodhuesit e energjisë elektrike: hidrocentrale, termike, termocentralet, CHP, prodhues automatik, Sistemi i Transmisionit, Shpërndarësit e energjisë elektrike.

Njësitë raportuese për bilancin e energjisë për ngrohje janë:

Prodhuesit e energjisë për ngrohje: termocentralet, CHP, prodhues automatik, ngrohjes qendrore, dhe Ndërmarrjet për transmetimin dhe shpërndarjen e ngrohjes dhe energjisë.

Njësitë raportuese të qymyrit për bilancin e energjisë janë:

Prodhuesit e lëndëve djegëse fosile të ngurta,
Prodhuesit e gazrave të prodhuara, dhe
Tregtarët e lëndëve djegëse fosile të ngurta.

Njësitë raportuese për bilancin energjetik të naftës dhe vajrave derivate janë:

Doganat e Kosovës,
Tregtarët e naftës dhe derivatet të naftës.

Njësitë raportuese për bilancin energjetik të drurit, karburanteve janë prodhuesit dhe tregtarët e druve të zjarrit, briket druri, fishekëve druri dhe qymyr druri.

Të dhënat janë grumbulluar nga entitetet si në vijim:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës - të dhënat demografike dhe sociale, të dhënat për importin dhe eksportin e të gjitha lëndëve djegëse;
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh. a) – të dhënat për thëngjillin (prodhimi, furnizimi dhe stoqet), si dhe të dhënat për konsumin e energjisë elektrike;
- Korporata distributive KESCO- të dhënat e konsumit të energjisë elektrike;
- Ngrohtorja e Prishtinës dhe Gjakovës.
- Operator i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu sh.a (KOSTT) - të dhëna periodike mujore, si dhe vjetore të balancës elektroenergjetike;
- “Kosova Thëngjilli” sh.a- të dhënat për tregtimin e thëngjillit të njomë dhe të terur, të nxjerrë nga mihjet në Kosovë;
- Ndërmarrjet e ngrohjeve qendrore - të dhënat për rrjedhat energjetike në ndërmarrjet e ngrohjes;
- MTI - të dhënat e përpunuara për produktet e naftës.

Në këtë dokument analiza e konsumit të energjisë është bazuar në anketat dhe studimet e zhvilluara. Ekstrapolimi i këtyre të dhënave është bazuar në indikatorët relevantë të zhvillimit, siç janë ata demografikë, socialë dhe ekonomikë.

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar, sistemuar dhe paraqitur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 mbi Rregullat për Balancat e Energjisë.

1. Balanca Vjetore e Energjisë për vitin 2020

Pjesët kryesore të “Balancës Vjetore të Energjisë për vitin 2020” janë: burimet primare, ku përfshihen prodhimi, përfitimi, importi, eksporti dhe stoku, si dhe konsumi i këtyre produkteve të energjisë. Të dy këto pjesë do të analizohen në vijim.

1.1. Burimet primare të energjisë

Struktura e energjisë primare e konsumuar në Kosovë për vitin 2020 e përbëhet nga: thëngjilli, produktet e naftës (benzina, nafta, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës-GLN), biomasa, hidroenergji, energjia e erës, energjia solare dhe biokarburantet. Energjia elektrike trajtohet si burim primar vetëm për sasinë e importit dhe eksportit. Kjo qasje është e bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it.

Në tabelën 1. Janë të paraqitura llojet e burimit të energjisë

Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve (produkteve) primare energjetike në dispozicion (ktoe)

Burimet e energjisë	2019	2020
Thëngjill	1556.38	1590.87
Produkte naftë	753.69	741.94
Biomasë	402.36	396.93
Hidroenergji	22.26	22.26
Energji solare	1.34	1.38
Energjia e erës	7.80	7.82
Energji Elektrike	4.60	-27.31
Totali	2748.43	2733.89

Siç vërehet në Tabela 1. sasia e përgjithshme (bruto) e energjisë në dispozicion për shfrytëzim (konsum) në vitin 2020 ishte 2733.89 ktoe, krahasuar më 2019 ka pasur rënie rreth 0.01%.




Figura 1. Pjesëmarrja e burimeve primare në dispozicion (%)

1.1.1. Thëngjilli

Sasia e thëngjillit në dispozicion për vitin 2020 ka qenë 1590.87 ktoe. Në Tabelën 2 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga thëngjilli.

Tabela 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion(ktoe)

Thëngjill	2019	2020
Antracit	0.00	0.05
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.47	1.35
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Linjit	1555.91	1589.47
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00
Totali i thëngjillit	1556.38	1590.87




Figura 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Nga Figura 2 shihet se linjiti është produkti dominues me pjesëmarrje prej 99.95% në totalin e thëngjillit si burim primar në dispozicion, i pasuar nga Thëngjill bituminoz dhe tjera 0.03%.

1.1.2. Produktet e naftës

Në Kosovë nuk nxirret naftë po ashtu nuk rafinohet nafta e papërpunuar bruto kështu që të gjitha nevojat për produkte nafte mbulohen nga importi. Importi i produkteve të naftës për vitin 2020 ka qenë 743.94 ktoe, që krahasuar me vitin 2019 ka pasur ulje për rreth 1.42%. Në tabelën 3. janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga produktet e naftës.

Tabela 3. Pasqyra e sasisë së produkteve të naftës (ktoe)

Produktet e naftës	2019	2020
Benzinë	61.95	52.70
Kerozinë (Jetfuel)	2.48	2.12
Vajra të rënda/mazuti	17.54	18.98
Naftë	498.49	502.80
GLN	29.92	35.32
Koks nafte	93.03	79.10
Mbetje nafte	1.00	2.00
Bitumen	44.90	45.26
Vajrat lubrifikante	5.37	5.65
Totali	754.69	743.94




Figura 3. Pjesëmarrja e produkteve të naftës si burime primare në dispozicion (%)

1.1.3. Biomasa (dru zjarri)

Sasia e konsumuar e druve të zjarrit në vitin 2020 sipas hulumtimit të zhvilluar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në vitin 2015 dhe azhurnuar me të dhënat e ekonomive familjare, rritjes ekonomike si dhe të dhënave nga Importi dhe eksporti i biomases është 376.93 ktoe. Krahasuar me 2019 kemi ulje për 1.35%. (Të dhënat bazike për konsumin e drurit për vitin 2015 janë marrë nga studimi për konsumin Energjisë në Ekonomit familjare, pasi që për arsye të pandemisë nuk kemi mundu me zhvilluar studimin mbi konsumin e drurit vitin 2020 dhe fillim vitin e vitit 2021).

1.1.4. Energjia elektrike

Bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it për paraqitjen e balancës së energjisë, energjia elektrike trajtohet si energji primare vetëm për sasinë e energjisë së importuar dhe asaj të eksportuar. Neto importi i kësaj energjie në vitin 2020 ka qenë -27.31 ktoe (import-eksport) që do të thotë se eksporti ka qenë më i madh se importi.

1.1.5. Hidroenergjia

Të dhënat për hidroenergjinë janë siguruar nga KESCO-i, KOSTT-i dhe ZRRE. Këto të dhëna janë bazuar në sasinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet: HC Ujmani, Kaskada e Lumbardhit (KELKOS), HCV në rrjetin e distribucionit+WP+Solar, DIKANCE, Hydroline-Albaniku, RADAC, Burimi, Wind Power, HC Brodi 2 "Eurokos-JH", LED LIGHT TECHNOLOGY, ONIX, Feti, HC Brezovica. Sasia e hidroenergjisë e prodhuar në hidrocentrale në vitin 2020 ka qenë 22.26 ktoe.

1.1.6. Energjia e Erës

Në vitin 2020, sasia e energjisë elektrike e gjeneruar nga era ka qenë 7.8 ktoe e njëjtë me vitin e kaluar

1.1.7. Energjia solare

Sasia e energjisë solare për vitin 2020 është 0.38 ktoe. Sipas vlerësimit të të dhënave konsumi i energjisë në ekonomit familjare është arritur vlera 0.37 ktoe.

1.1.8. Biokarburantet

Në vitin 2020 nuk është evidentuar import i biokarburanteve. Po ashtu nuk kemi të dhëna për prodhimin e këtij produkti energjetik..

1.2. Konsumi final i energjisë

Të dhënat për sasinë e energjisë së konsumuar për vitin 2020² janë bazuar në hulumtimet e ndryshme që janë zhvilluar në Kosovë nëpër vite nga Institucione të ndryshëm.

Sasia e konsumit të energjisë nëpër sektorë është paraqitur në tabelën 4.

²“Konsumi i energjisë në Kosovë”, realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2009,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e industrisë dhe mundësia e përmirësimit të efikasitetit”, realizuar nga MPR GROUP në vitin 2010,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë dhe mundësia e përmirësimit të efikasitetit”-realizuar nga Instituti “Intech” në vitin 2011,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve”-realizuar nga Studio projektuese “Links 4” në vitin 2012,

“Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë”, realizuar nga CRES në vitin 2011;

“Studimi mbi konsumin e energjisë në sektorin e bujqësisë”, realizuar nga “Intech” në vitin 2013;

“Studimi mbi konsumin e energjisë në sektorin e transportit”, realizuar nga “Intech” në vitin 2014

“Studimi mbi konsumin e energjisë në sektorin e Industrisë”, realizuar nga “ASK” në vitin 2015

“Studimi mbi konsumin e energjisë në sektorin e Ekonomive familjare” nga ASK në vitin 2016

Tabela 4. Pasqyra e pjesëmarrjes së gjithë sektorëve në konsumin final energjetik (ktoe)

Sektorët ekonomik	2019	2020
Sektori i industrisë	319.81	319.92
Sektori i amvisërisë	575.38	628.09
Sektori i shërbimeve	151.73	146.06
Sektori i bujqësisë	38.02	36.32
Sektori i transportit	422.58	412.46
Totali	1507.51	1542.85

Nga tabela 4 shihet se konsumi final i energjisë për vitin 2020 ka qenë 1542.85 ktoe, në krahasim me vitin 2019 ka pasur rritje për rritja është shumë e vogël (rreth 0.07%).




Figura 4. Pjesëmarrja e sektorëve të ekonomisë në konsumin e energjisë (%)

Konsumi final i energjisë për qëllime jo energjetike për vitin 2020 ka qenë 45.26 ktoe. Nën-produkti i naftës, bitumeni është konsumuar për qëllime jo energjetike në vitin 2019 në sasi prej 45.26 ktoe. Në vazhdim paraqitet konsumi final jo energjetik dhe konsumi final i energjisë.

Tabela 5. Konsumi final jo energjetik (ktoe)

Sektorët ekonomik	2019	2020
Industria kimike	0.00	0.00
Sektorët tjerë	44.90	45.26
Totali	44.90	45.26

Në Tabelën 6. paraqitet gjendja e sasisë së konsumit final të energjisë sipas llojeve të produkteve energjetike

Tabela 6 . Pasqyra e konsumit final të të gjitha burimeve të energjisë (ktoe)

Burimi	2019	2020
Thëngjill	21.43	26.84
Produkte nafte	699.78	686.11
Biomasë	402.36	396.93
Energji elektrike	405.40	414.13
Energji solare	0.44	0.46
Ngrohje e përfituar	19.42	18.38
Totali	1507.51	1542.85




Figura 5. Pjesëmarrja në konsum e të gjitha burimeve të energjisë (%)

1.2.1. Konsumi final i thëngjillit

Konsumi final i llojeve të thëngjillit paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 7. Pasqyra e konsumit final të thëngjillit (ktoe)

Thëngjill	2019	2020
Antracit	0.00	0.05
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.47	1.35
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Linjit	28.50	78.01
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Totali	28.97	79.57

Sasia e konsumuar e thëngjillit për vitin 2020 është 79.57 ktoe. Nga tabela 7 dhe figura 6 shihet se linjiti ishte lloji i thëngjillit që më së shumti është konsumuar në vitin 2020.




Figura 6. Pasqyra e konsumit të thëngjillit (%)

1.2.2. Konsumi final i produkteve të naftës

Në vijim paraqitet konsumi final i të gjitha produkteve të naftës:

Tabela 8. Pasqyra e konsumit final të produkteve të naftës (ktoe)

Produkte naftë	2019	2020
Benzinë	61.95	52.70
Kerozinë (Jetfuel)	2.48	2.12
Vajra te rënda/mazuti	12.86	14.29
Naftë	496.77	501.09
GLN	29.92	35.32
Koks naftë	93.03	79.10
Bitumen	44.90	45.26
Vajrat lubrifikante	5.37	5.65
Totali	747.29	735.54




Figura 7. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës (%)

Konsumi i produkteve të naftës për vitin 2020 ka pasur ulje për 1.57%, ne raport me vitin 2019.

Siç shihet nga tabela 8 nafta është nën-produkti më i konsumuar në vitin 2020 me një pjesëmarrje prej 501.99 ktoe, ose rreth 68.13% e konsumit total të derivateve të naftës, pasuar nga koks nafte, Benzina, etj.

1.2.3 Konsumi final i energjisë elektrike

Në vitin 2020 konsumi i energjisë elektrike ka qenë 414.13 ktoe në krahasim me vitin 2019 ka pasur ngritje prej 2.15 %. Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i energjisë elektrike në të gjithë sektorët ekonomik

Tabela 9. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike(ktoe)

Sektori	2019	2020
Industria	89.73	85.49
Transporti	0.00	0.00
Amvisëria	217.40	238.84
Bujqësia	11.96	9.66
Shërbimet	86.31	80.15
Totali	405.40	414.13




Figura 8. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomikë (%)

Siç shihet nga tabela 9, sektori i amvisërisë është sektori me konsumin më të madh të energjisë elektrike prej 58% të konsumit total të energjisë elektrike. Sektori i dytë që ka konsumuar më së shumti energji elektrike është sektori i industrisë me konsum prej 21% të sasisë së përgjithshme të kësaj energjie, etj.

1.2.4. Konsumi final i ngrohjes së përfituar

Konsumi total i ngrohjes së përfituar për vitin 2020 ka qenë 18.38 ktoe, ose një rritje ulje 5.35 % krahasuar me vitin 2019. Amvisëria është konsumatori kryesor me një konsum prej 11.98 ktoe, ose 65% të konsumit total të ngrohjes së përfituar, pasuar nga sektori i shërbimeve me konsum prej 6.40 ktoe, ose 35%.

Tabela 10. Pasqyra e konsumit të ngrohjes së përfituar në të gjithë sektorët ekonomik shprehur në ktoe

Sektor	2019	2020
Industria	0.00	0.00
Transporti	0.00	0.00
Amvisëria	13.24	11.98
Bujqësia	0.00	0.00
Shërbimet	6.18	6.40
Totali	19.42	18.38

1.3. Konsumi i energjisë në sektorin e industrisë

1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë

Konsumi i energjisë (i të gjitha produkteve energjetike), në sektorin e industrisë të vitit 2020 ka qenë 319.92 ktoe. Krahasuar me vitin 2019 kemi pothuajse konsum të njëjtë (rritje për 0.04% krahasuar me vitin 2019).

Tabela 11. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

Produkti energjetik	2019	2020
Thëngjill	10.48	15.24
Produkte nafte	203.14	201.09
Biomasaë	16.47	18.11
Energji elektrike	89.73	85.49
Totali	319.81	319.92

Produktet e naftës janë produktet më të konsumuara në sektorin e industrisë, me një sasi prej 63 %, pasuar nga energjia elektrike me 26%, biomasa 6% dhe thëngjilli 5% të konsumit të përgjithshëm të energjisë në sektorin e industrisë.




Figura 9. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (%)

1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë

Në tabelën 12 shihet pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë. Pjesëmarrja e linjitit për vitin 2020 është rreth 90.69%, thëngjill bituminoz me thëngjill tjetër me 8.91% , antraciti dhe koks dhe gjysmë koks përbejnë më pak se 0.33%, në kuadër të konsumit total të thëngjillit.

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit lloj të thëngjillit në sektorin e industrisë.

Tabela 12. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë (ktoe)

Thëngjill	2019	2020
Antracit	0.00	0.05
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.47	1.36
Linjit	10.00	13.82
Koks dhe gjysmë koks	0.01	0.01
Totali	10.48	15.24




Figura 10. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë (%)

1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë

Në tabelën 13 shihet se në konsumin e derivateve të naftës në sektorin e industrisë në vitin 2020 prinë nafta (dizel) me pjesëmarrjen prrreth 49 %.

Tabela 13. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e industrisë(ktoe)

Produktet e naftës	2019	2020
Benzinë	0.09	0.08
Gazoil	0.00	0.00
Kerozinë	0.00	0.00
Kerozinë (Jet fuel)	0.00	0.00
Vajra të rënda /mazut	8.91	8.91
Naftë	94.92	95.07
GLN	7.45	6.62
Koks nafte	86.41	85.06
Produkte tjera nafte	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00
Totali	197.79	195.74




Figura 11. Pjesëmarrja në konsum e produkteve të naftës në sektorin e industrisë (%)

Sektori i industrisë përbëhet prej degëve industriale si në vijim: industria e hekurit dhe e çelikut, industria e metaleve jo ferore, industria kimike, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore, industria e nxjerrjes së xeheve, industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit, industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes, industria e letrës dhe stampimit, inxhinieringut dhe industrisë të tjera të metaleve.

1.3.4 Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë

Konsumi total i energjisë elektrike në sektorin e industrisë për vitin 2020 ka qenë 85.49 ktoe (sipas studimit të fundit të konsumit të energjisë të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe përditësimit me të dhëna shtese nga terreni) . Industria e hekurit dhe e çelikut është dega e industrisë me konsumin më të lartë të energjisë elektrike në sasi prej 44% të konsumit total të energjisë elektrike në sektorin e industrisë, pasuar nga industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit 35%, e kështu me radhë.

Tabela 14. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (ktoe)

Nënsëktorët e industrisë	2019	2020
Industria e hekurit dhe e çelikut	39.22	37.68
Industria e metaleve joferore	1.36	1.34
Industria kimike	0.30	0.31
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	4.90	4.93
Industria e nxjerrjes së xeheve	1.00	1.05
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	30.04	29.84
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.08	0.08
Industria e letrës dhe stampimit	0.13	0.14
Inxhinieringu dhe industrisë të tjera të metaleve	0.01	0.01
Industrisë të tjera	12.69	10.11
Totali	89.73	85.49




Figura 12. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (%)

1.3.5 Pjesëmarrja e degëve të industrisë në konsumin e energjisë

Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore konsumon 36.68 % të sasisë së konsumit të energjisë në gjithë sektorin e industrisë, industria e hekurit dhe çelikut 21.96% e sasisë së konsumit të energjisë në gjithë sektorin e industrisë.

Metoda e vlerësimit bazohet në anketat e realizuara në vitin 2009 ,2010 dhe 2015 si trendi dhe i BVP-ës nëpër vitet (e realizuar nga ASK), duke u bazuar në përqindjet e pjesëmarrjes së degëve në totalin e produkteve energjetike që ka tërhequr sektori.

Tabela 15. Pasqyra e konsumit total të energjisë të nën sektorëve të industrisë (ktoe)

Degët e industrisë	2019	2020
Industria e hekurit dhe e çelikut	70.24	72.95
Industria e metaleve joferrore	23.65	23.74
Industria kimike	1.33	1.24
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	117.30	116.26
Industria e nxjerrjes së xeheve	1.91	1.97
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	48.94	49.72
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.10	0.11
Industria e letrës dhe stampimit	0.29	0.30
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01	0.01
Industritë tjera	56.05	53.63
Totali	319.81	319.92




Figura 13. Pasqyra e konsumit të energjisë të nën sektorëve të industrisë (%).

1.4. Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë

1.4.1. Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë

Energjia, e cila konsumohet nga sektori i amvisërisë shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ngrohjen e ujit sanitar, gatim, ndriçim dhe përdorim të pajisjeve elektrike për nevoja familjare dhe individuale.

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2020 ka qenë 628.09 ktoe. Ka pasur rritje të konsumit të energjisë rreth 2.88% krahasuar me vitin 2019.

Tabela16. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Burimi	2019	2020
Thëngjill	2.51	2.84
Produkte nafte	10.98	10.26
Biomasë	366.22	364.03
Energji elektrike	217.40	238.84
Energji solare	0.13	0.14
Ngrrohje e përfituar	13.24	11.98
Totali	610.49	628.09




Figura 14. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (%)

Produkti energjetik më i konsumuar në sektorin e amvisërisë për vitin 2020 është biomasa që përbën rreth 58% të konsumit total të energjisë së konsumuar në këtë sektor. Pas biomasës vjen energjia elektrike, e cila është konsumuar në sasi prej 38% të konsumit total e kështu me radhë. Tabela 16 dhe figura 14 paraqesin pasqyrën e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë.

1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë

Në vitin 2020, linjiti është lloji i vetëm i thëngjillit i konsumuar në sektorin e amvisërisë.

Tabela17. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë shprehur në (ktoe)

Thëngjill	2019	2020
Antracit	0.00	0.00
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.00	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Lignit/thëngjill i murrmë	2.51	2.84
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00
Totali	2.51	2.84




Figura 15. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë (%)

Duhet cekur në këtë rast se jemi shërbyer vetëm me të dhënat administrative të KEK-ut, Divizionit të Thëngjillit dhe nuk janë bërë vlerësime të konsumit të thëngjillit nga mihjet private siç ka ndodhur viteve të kaluara.

1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë

Në tabelën 18 është pasqyruar gjendja e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë. GLN është produkti energjetik më i konsumuar në kuadër të produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë në sasi energjie prej 5.68 ktoe, e pasuar nga nafta me 3.67 ktoe dhe benzina 0.91 ktoe.

Tabela 18. Pasqyra e konsumit të të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Produktet e naftës	2019	2020
Benzinë	0.92	0.91
Naftë	3.68	3.67
GLN	6.39	5.68
Totali	10.98	10.26




